



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 4 Datë 10.04.2017

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS “ PËR PËRDORIM TË BURIMEVE UJORE”

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012 dt.15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore” gërma b, dhe të nenit 41 “Përdorimi me leje i ujit” gërma a dhe ë; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 , “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin-Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I :

- 1- Të miratojë kërkesën e subjektit “ **NORDIN**”shpk me administrator z. Dedë SMAKAJ në Laç Vau-Dejës, Njësia Administrative Vau-Dejës, Bashkia Vau-Dejës, Qarku Shkodër, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Tamzës (Tanushit)** për Akuakulturë. Koordinatat e burimit ujor: X– 46 53 650; Y – 43 87 630; Z – + 26 m; Prurja mesatare vjetore e burimit :  $Q=0.85- 1.1 \text{ m}^3/\text{sek}$ . Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është  $0.01 \text{ m}^3/\text{sek}$  (10 l/sek).
- 2- Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin PLLUMBI



KRYETAR

Paulin RADOVANI